



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:168999

Datë: 08.09.2022

Numri i dokumentit: 03401585

**PKR.nr.113/22**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda**, nga Kryetari i Trupit Gjykes – Gjykatësi **Drilon HARAÇIA**, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale ndaj të akuzuarve B. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, dhe të akuzuarit M. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.185-380/12 PE të dt.18.08.2022, pas caktimit së shqyrtimit fillestar me dt.05.09.2022 dhe 08.09.2022 në prezencën e Prokurores së Shtetit dhe ta akuzuarve dhe mbrojtësit të akuzuarit të dytë av.Afrim Radoniqi nga Gjakova, sipas autorizimit, dhe sipas detyrës zyrtare me dt.08.09.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HUDHET** Aktakuza e të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër **PP/I.nr.185-380/12 PE të dt.18.08.2022** dhe **PUSHOHET PROCEDURA PENALE** kundër të akuzuarve **B. K.**, data e lindjes . . . në Gjakovë, me banim rr. “V. . .” Komuna Gjakovë, nga i ati B. dhe nëna V. e gjinisë P., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, me numër personal . . . Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe të akuzuarit **M. K.**, data e lindjes . . . në Gjakovë, me banim rr. “V. . .” Komuna Gjakovë, nga i ati . dhe nëna V. e gjinisë P., ka të kryer shkollën mesme, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, me numër personal . . ., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **të akuzuar për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale (ndalesë absolut mbi ndjekjen penale)**

Ndaj të akuzuarve B. K. dhe M. K., në bazë të nenit 374 par.3 të KPRK-së, bëhet konfiskimi i një (1) armë BROËNING FN Cal.9x9mm me numër serik 6T850, 183435 dhe një (1) armë EKOL TUNA me nr. serik #ET-1230035 cal. 8mm me një karikator, konfiskohen si objekte të kryerjes së verës penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda Themelore në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.185-380/12 PE të dt.18.08.2022, kundër të akuzuarve B. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 prg.1 të KPK-së, dhe të akuzuarit M. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 prg.1 të KPK-së,

Kjo aktakuzë në Gjykatë ka arritur me dt.18.08.2022, ndërsa tek gjykatësi i çështjes me dt.19.08.2022, ku menjëherë është caktuar shqyrtimi fillestar me dt.05.09.2022 (i cili nuk është mbajtur në mungesë të akuzuarit të parë dhe kërkesës së të akuzuarit të dytë pasi që i njëjti në seancë ka kërkuar të angazhohj mbrojtës), ku pastaj shqyrtimi fillestar është shtyre me dt.08.09.2022.

**Gjykata duke analizuar veprën penale** mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, **ku për këtë veprë penale është parapare dënimi me gjobë deri në shumën prej 7.500.00 € ose me burgim deri në pesë vjet**, që do të thotë se parashkrimi relativ sipas dispozitës së nenit 90 par.1 nënpar.4 të KPPRK-së, paraqitet kur kalon koha prej 5 viteve, nga momenti i kryerjes së veprës penale. Ndërsa sipas dispozitës të nenit 91 par.6 të KPPRK-së paraqitet parashkrimi absolut paraqitet kur kalon dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit relativ, përkatësisht periudha prej 10 vitesh. Ndërsa të akuzuarit B. K. dhe M. K. që të dy nga Gjakova, akuzohen se i kanë kryer veprën penale me dt.09.09.2012 (koha e kryerjes së veprave penale) çka do të thotë se me dt.08.09.2022 kanë kaluar 10 vite, për çka ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar afati i lartcekur.

Gjykata ka ardhë në përfundim se pasi që ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale, të veprës së lartcekur edhe përkundër veprimeve të Gjykatës, në kuptim të dispozitës të nenit 358 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, lidhur me nenin 90 par.1 nën par.4 lidhur me nenin 91 par.6 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata, ndaj të akuzuarve B. K. dhe M. K., në bazë të nenit 374 par.3 të KPPRK-së, bëhet konfiskimi i një (1) armë BROËNING FN Cal.9x9 mm me numër serik 6T850, 183435 dhe një (1) armë EKOL TUNA me nr. serik #ET-1230035 cal. 8 mm me një karikator, konfiskohen si objekte të kryerjes së veprës penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale është marr në kuptim të nenit 454 par.1 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i Krimeve të Rënda-**  
**PKR.nr.113/22, më datë 08.09.2022**

**Zyrtarja Ligjore,**  
**Arbënore Basha**

**Kryetari i Trupit Gjykoës - Gjykatësi**  
**Drilon Haraçia**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 3 (tre) ditësh pas marrjes së të njëjtës, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.